

# **Pjese nga Vendimi Nr. 72, date 15.2.2001, Per miratimin e “rregullore e produkteve per mbrojtjen e bimeve ”**

## **Regjistrimi i PMB-ve**

### **Aplikimi per Regjistrim**

#### **Neni 5**

Personat juridike e fizike, vendas e te huaj te interesuar te Aplikojne per regjistrimin e nje PMB-je duhet te paraqesin prane KSHRPMB Dosjen e Regjistrimit te plotesuar sipas kerkesave te paraqitura ne Aneksin 1.

#### **Neni 6**

Dosja e Regjistrimit duhet te paraqitet ne gjuhen shqipe ose angleze ne kater kopje. Te dhenat e paraqitura ne dosje, per te cilat Aplikanti e justifikon kerkesen per nje garanci ne mbrojtjen e tyre, duhet ti deklaroje paraprakisht si konfidenciale

#### **Neni 9**

KSHRPMB pasi shqyrton Dosjen e Regjistrimit mund te vendose :

1. Te nderprese proceduren e regjistrimit kur

1.1 Nga Inspektoriati i Mbrojtjes se Bimeve ka te dhena te besueshme se Aplikanti e ka futur ne treg PMB-ne perpara se ajo te jete regjistruar.

1.2 Ne Dosjen e Regjistrimit mungojne te dhenat e kerkuara sipas Aneksit 1, duke vene ne dijeni Aplikantin per plotesimin e tyre.

2. Te kerkoje informacion plotesues, te cilin Aplikanti e paraqet brenda nje kohe qe KSHRPMB e gjykon te arsyeshme por qe nuk i kalon dy vjete.

3. Te nderprese perfundimisht procedurat e regjistrimit kur:

a) PMB-ja e futur ne treg para perfundimit te procedurave te regjistrimit, nuk eshte terhequr nga tregu

b) nuk sigurohen te dhenat e kerkuara ne paragrafin 1 deri ne gjashte muaj pas venies ne dijeni te te interesuarit per plotesimin e tyre,

c) nuk sigurohet ne kohen e caktuar informacioni plotesues i kerkuar ne paragrafin 2.

4. Te ngarkoje IMB, IKV, ISHP, te bejne eksperimentime me karakter biologjiko-agronomik dhe mjekesor - toksikologjik te cilat komisioni i gjykon te nevojeshme.

5. KSHRPMB , mbeshtetur mbi fakte te reja shkencore mund te beje rishikimin e PMB-ve te regjistruara ne çdo kohe, dhe te mare vendime sikurse parashtrohen ne paragrafet 2, 3b, 4, te ketij Neni.

## **Certifikata e Regjistrimit**

### **Neni 10**

Certifikata e Regjistrimit eshte dokumenti perfundimtar i procedures se regjistrimit te nje PMB-je. Ajo leshohet nga Ministri per perdorimin ne teritorin e Republikes se Shqiperise

### **Regjistrimi i nje PMB-je lenda aktive e te cilit eshte ne Aneksin I te Direktives Nr.91/414/EEC**

### **Neni 11**

1.KSHRPMB i propozon Ministrit regjistrimin e nje PMB-je ne qoftese:

- a) jane plotesuar kushtet qe parashtrohen ne kete Rregullore.
- b) lenda aktive e PMB-se eshte ne Aneksin I te Direktives Nr.91/414/EEC.

2.Regjistrimi eshte i vlefshem per nje periodhe 10 vjecare.

### **Regjistrimi i nje PMB-je me permbajtje te nje Lende aktive te re**

### **Neni 12**

1.KSHRPMB i propozon Ministrit regjistrimin e nje PMB-je ne qoftese se jane plotesuar kushtet qe parashtrohen ne kete Akt.

2.Regjistrimi eshte i vlefshem per nje periodhe 3 vjecare.

3.KSHRPMB i propozon Ministrit amendimin ose anulimin e nje vendimi te regjistrimit ne perputhje me Vendimet e metejshme te Komunitetit European per kete PMB.

### **Regjistrimi i nje PMB-je me permbajtje te nje lende aktive te vjeter**

### **Neni 13**

1. KSHRPMB i propozon Ministrit regjistrimin e nje PMB-je ne qoftese:

- a) jane plotesuar kushtet qe parashtrohen ne kete rregullore.
- b) Lënda Aktive eshte e regjistruar ne nje nga shtetet anetare te KE, SHBA, Japoni, Kanada.
- c) Kushtet klimatike, agroteknike, mjedisore ne te cilat do te perdoret jane te krahasueshme me ato te shteteve te permendura ne paragrafin 1.b te ketij Neni.

2. Regjistrimi eshte i vlefshem deri ne ate date qe eshte regjistruar ne shtetet e permendura ne paragrafin 1.b te ketij Neni, por jo me shume se pese vjete.

3. KSHRPMB i propozon Ministrit amendimin ose anulimin e nje vendimi te regjistrimit ne perputhje me Vendimet e metejshme te Komunitetit European per kete Lëndë Aktive.

## **Procedurat e thjeshtuara per regjistrimin e PMB-ve identike me PMB-te e regjistruara**

### **Neni 14**

1. Nje PMB quhet identike me nje PMB te regjistruar neqoftese:

- a) origjina eshte nga i njejt prodhues,
- b) permban te njejtat lende aktive dhe sasi , me te njejtin minimum respektiv te pastertise dhe te njejtat papasterti dhe sasi me te njejtin maksimum te permbajtjes se tyre,
- c) eshte identik ne perberesit e formulimit, ne etikete, dhe ambalazhim por ka emer tregetar te ndryshem .

### **Neni 15**

1. Regjistrimi i nje PMB-je identike me nje PMB e cila eshte regjistruar me pare, por me perjashtim te PMB-ve te regjistruara sipas Nenit 16, behet me procedure te thjeshtuar per te cilen Aplikanti duhet te paraqese:

- a) nje dosje me te dhena, te cilat plotesojne kushtet per tu quajtur identik sipas Nenit 14.
- b) nje deklarate qe PMB-ja e cila kerkohet te regjistrohet eshte identike me nje PMB te regjistruar me pare,
- c) etiketen

2. Regjistrimi i nje PMB-je identike eshte i kufizuar ne te njejtin periudhe kohe dhe u neneshtrohet te gjitha vendimeve qe mund te meren per PMB-ne identike te regjistruar me pare.

### **Autorizimi per perdorimin e perkoheshem te nje PMB-je te pa regjistruar**

### **Neni 16**

1. Nje PMB e pa regjistruar autorizohet per tu perdorur per nje sasi dhe kohe te kufizuar kur luftimi i nje parazitit gjykohet se nuk realizohet me PMB-te e regjistruara.

2. Regjistrimi behet per nje periudhe te kufizuar kohe jo me te gjate se nje vit.

3. Drejtoria e Sherbimit te Mbrojtjes se bimeve ka te drejte ti propozoje Ministrit per autorizimin e perdorimit te perkoheshem te nje PMB-je te pa regjistruar.

4. Autorizimi per perdorimin e perkoheshem te nje PMB-je te pa regjistruar behet nga Ministri ne bashkepunim me Ministrin e Shendetesise .

### **Shtesat dhe Anullimi i vendimit te regjistrimit te nje PMB-je**

### **Neni 17**

1. KSHRPMB mund ti propozoje Ministrit shtesa ne Certifikaten e Regjistrimit te nje PMB-je kur:

- 1.1. ne baze te te rejave tekniko shkencore kerkohen modifikime ne menyren e perdorimit
- 1.2. Aplikanti e kerkon me shkrim nje gje te tille duke paraqitur dokumentacionin shtese per Dosjen e Regjistrimit

2. KSHRPMB mund ti propozoje Ministrit anullimin e vendimit te regjistrimit te nje PMB-je kur :

- 2.1. nuk ploteson me kushtet per te qene i regjistruar sipas kerkesave te parashtruara ne kete Rregullore.
- 2.2. permban lende aktive te cilat nuk jane aprovuar per tu futur ose jane hequr nga Aneksi I i Direktives Nr.91/414/EEC.

2.3. konstatohet se ne Dosjen e Regjistrimit jane paraqitur te dhena false ose mashtruese.

2.4. aplikanti e kerkon me shkrim nje gje te tille

### **Neni 18**

Pas anulimit tregetaret jane te detyruar t'ja kthejne PMB-ne mbajtesit te Certifikates se Regjistrimit i cili me shpenzimet e veta dhe brenda nje periudhe nje vjecare duhet te beje asgjesimin sipas kushteve qe parashikon legjislacioni ne fuqi.

## **Rinovimi i Regjistrimit**

### **Neni 19**

1.Regjistrimi i nje PMB-je mund te rinovohet mbi bazen e kerkeses, nese kushtet ne te cilat ai eshte regjistruar vazhdojne te plotesojne kerkesat e kesaj rregulloreje.

2.Aplikanti duhet te beje kerkesen per rinovim nje vit perpara perfundimit te afatit te regjistrimit. Rinovimi i regjistrimit i neneshtrohet te gjitha procedurave per regjistrimin e nje PMB-je te cilat parashikohen ne kete Rregullore.

## **Etiketa**

### **Neni 20**

1.PMB-te tregetohen me etikete ne gjuhen shqipe. Etiketa eshte pjese perberese e Certifikates se Regjistrimit. Mbi te nuk lejohet te behen korigjime, fshirje ose te vendoset etikete tjeter.

2.Nje etikete duhet te permbaje:

Emrin tregetar dhe percaktimin "Produkt per Mbrojtjen e Bimeve"

Emrin dhe adresen e mbajtesit te Certifikates se Regjistrimit dhe fabrikuesit te PMB-se.

Emrat e lendeve aktive sipas nomenklaturave standarte nderkombetare

Numri i partise se mallit ose shenja te tjera identifikuese

Reziqet e vecanta ndaj njerezve, kafsheve e mjedisit te dhena konforme frazave standarte.

Masat per mbrojtjen e njerezve, kafsheve dhe mjedisit te dhena konforme frazave standarte.

Shenjat e pergjitheshme ne raste helmimi, udhezime per ndihmen e pare dhe keshilla per mjekun.

Tipi i PMB-se (p.sh. insekticid, erbicid, etj.)

Menyra e veprimit (p.sh. sistemik, kontakti, me veprim parambrojtes, kurativ, etj.)

Tipi i formulimit

Dozat e perdorimit te shprehura ne sistemin metrik per kulturat dhe kushtet specifike bujqesore, agroteknike dhe mjedisore.

Rekomandime lidhur me shmangien e rezistences.

Periudha e pritesmerise (karenca)

Te dhena per fitotoksicitetin ne kultura e kultivare te ndryshem si dhe ndikimi indirekt ne kulturat pasardhese.

Instrukcion per asgjesimin e produktit dhe ambalazheve.

Afati i fundit i perdorimit

Instrukcion per kushtet e ruajtjes

Kur permbajtja etiketes nuk mund te perfshihet ne permasat e ambalazhit atehere mund te perdoret nje flete e vecante, ndersa ne etikete vendoset shenimi : "Lexo instrukcionin e perdorimit".

3. Etiketa nuk duhet te permbaje shenime te tilla si "jo helmues" ose "i pa demshem" ose shenime te tjera te ngjashme. Deklarime te tilla mund te vihen ne etikete vetem ne rastet kur kane te bejne me bletet ose insektet e dobishme per kushte te percaktuara te perdorimit (p.sh. gjate lulezimit te nje kulture) .

## **Reklama e PMB-ve**

### **Neni 22**

- 1.Reklama ne media ose ne forma te tjera lejohet vetem per PMB-te e regjistruara dhe konforme Dokumentit te Regjistrimi.
- 2.Ne vartesi te tipit te reklames tekstet dhe figurat duhet te jene te lexueshme dhe te degjueshme qarte vecanerisht kur ato kane te bejne me mbrojtjen e njerezve, kafsheve dhe mjedisit.

## **KREU III IMPORTIMI, RUAJTJA DHE TREGETIMI**

### **Kushtet per tregetin e PMB-ve**

### **Neni 23**

- 1.PMB-te importohen dhe tregetohen ne qoftese jane regjistruar ne perputhje me kete Rregullore.
- 2.Regjistrimi nuk eshte i nevojshem kur ka prova te mjaftueshme se nje PMB do te prodhohet ose do te qendroje e magazinuar per tu eksportuar ne nje shtet tjetër.

### **Neni 24**

Te drejten e importimit dhe tregetimit te PMB-ve e kane personat juridike e fizike, vendas apo te huaj, te diplomuar ne Fakultetin e Agronomise dhe te paisur me Deshmi Kualifikimi nga Instituti i Mbrojtjes se Bimeve, ose qe kane te punesuar persona te tille.

### **Neni 25**

Importimi i PMB-ve behet vetem me Licence Importi te leshuar nga Ministri sipas modelit te paraqitur ne Aneksin 2, Shtojca 2. Te kesaj Rregulloreje.

### **Neni 26**

Personat qe kerkojne Licence Importi per PMB paraqesin ne DSHMB keto dokumenta :

- a.Kerkesen sipas Aneksit 2, Shtojca 1.
- b. Nje autorizim te leshuar nga mbajttesi i Dokumentit te Regjistrimit per shitjen e PMB-ve ne Republiken e Shqiperise
- c. Vendimin e Gjykates per njohjen si Person Juridik ose Fizik
- d. Lejen e Tregetimit te PMB-ve te leshuar nga Drejtoria e Bujqesise se Rrethit (DBU)
- e. Deshmine e Kualifikimit

Komisioni duhet te jape pergjigje brenda 10 diteve nga data e paraqitjes se Dosjes ne DSHMB.

### **Neni 27**

1. Kekesa per Licence Importi shqyrtohet nga nje komision i ngritur prane Drejtorise se Sherbimit te Mbrojtjes se Bimeve.

2. Komisioni perbehet nga :

Inspektori i DSHMB

Inspektori i Mbrojtjes se Bimeve te DBU-se prej nga eshte paisur me Leje Tregetimi

Pergjegjesi i Sektorit te Pesticideve ne IMB

Nje Inxhinier Kimist nga IMB

3. Ky Komision ka te drejte te refuzoje kerkesen per Licence Importi kur konstaton se personi nuk ploteson kushtet e parashikuara ne kete rregullore ose gjate veprimtarise se tije jane konstatuar shkelje te kesaj Rregulloreje. Ne kete rast i interesuari ka te drejte te ankohet tek Ministri i Bujqesise dhe Ushqimit brenda 15 diteve nga data e njoftimit te refuzimit.

4. Ministri, me propozim te Drejtorit te Sherbimit te Mbrojtjes se Bimeve, ka te drejte te beje te pa vlefshme Licencen e Importimit kur mbajtesi i Licences ka futur per qellime tregetimi ne teritorin e RSH PMB te pa regjistruara ose qe nuk plotesojne kushtet e paracaktuara ne Certifikaten e Regjistrimit.

### **Neni 28**

Personat qe kerkojne Leje Tregetimi per PMB paraqesin ne DBU keto dokumenta :

a. Kerkesen sipas Aneksit 2, Shtojca 3. te kesaj Rregulloreje.

b. Miratimin nga komisioni i ngritur sipas Nenit 36 i mjediseve qe do te perdoren per magazinimin dhe shitjen e PMB-ve.

e. Deshmine e Kualifikimit

Komisioni duhet te jape pergjigje brenda 15 diteve nga data e paraqitjes se Kerkeses ne DSHMB.

### **Neni 29**

1. Kerkesa per Leje Tregetimi shqyrtohet nga nje komision i ngritur me Urdher te Drejtorit te DBU-se.

2. Ky Komision ka te drejte te refuzoje kerkesen per Leje Tregetimi kur konstaton se personi nuk ploteson kushtet e parashikuara ne kete Rregullore ose gjate veprimtarise se tij jane konstatuar shkelje te kesaj Rregulloreje. Ne kete rast i interesuari ka te drejte te ankohet tek Ministri i Bujqesise dhe Ushqimit brenda 15 diteve nga data e njoftimit te refuzimit.

3. Drejtori i Sherbimit te Mbrojtjes se Bimeve si dhe Drejtori i DSHB ne rreth kane te drejte te bejne te pa vlefshme Lejen e Tregetimit kur verejne se mbajtesi i Lejes tregeton PMB te pa regjistruara ose qe nuk plotesojne kushtet e paracaktuara ne Certifikaten e Regjistrimit.

### **Neni 30**

Magazinat e PMB-ve jane objekte qe sherbejne per ruajtjen dhe shitjen e tyre me shumice.

Ato ndertohen larg shkollave, shtepive, spitaleve, qendrave tregetare, magazinave a fabrikave te perpunimit te ushqimeve, ujrave te rrjedhshem dhe baseneve ujore.

Keto magazina rrethohen me gardh ose me mur ne nje largesi jo me pak se tre meter nga godina. Rreth e qark godines behet nje kanal i thelle e i gjere jo me pak se 50 cm.

### **Neni 31**

PMB-te ne magazine vendosen te ndare nga njeri-tjetri, te ambalazhuar ne menyre te rregullt, ne ambalazhe origjinale dhe me etiketat e miratuara.

Ndalohet mbajtja e prodhimeve ushqimore, foragjereve dhe farerave ne magazinat e PMB-ve.

Ndalohet riambalazhimi i PMB-ve ne magazinat qe perdoren per ruajtjen dhe shitjen me shumice te tyre.

Nderrimi i destinacionit te magazinave te PMB-ve per qellime te tjera, mund te behet vetem pas miratimit nga komisioni i permendur ne Nenin 36 te kesaj Rregulloreje.

### **Neni 32**

PMB-te ne magazina duhet te jene te identifikuara nepermjet certifikates se origjines dhe cilesise. Hyrja dhe dalja e tyre nga magazina behet me dokumenta te rregullta dhe shenimet perkatese pasqyrohen ne librin e magazines te dhene ne Shtojcen 8 te kesaj Rregulloreje. Ky liber bashke me flete hyrjet dhe flete daljet ruhet per 5 vjet.

Ndalohet shitja me shumice e PMB-ve personave pa Leje Tregetimi.

Ndalohet shitja e PMB-ve me pakice tek perdoruesi i fundit drejtperdrejte nga magazina.

### **Neni 33**

Dyqanet e PMB-ve jane objekte qe sherbejne per shitjen me pakice drejtperdrejte tek perdoruesi.

Ne dyqanet e PMB-ve ndalohet:

- mbajtja dhe shitja e ushqimeve per njerez dhe kafshe.
- mbajtja e PMB-ve ne ambalazhe jo origjinale.
- riambalazhimi i PMB-ve.

### **Neni 34**

Ne dyqanet e PMB-ve shitja behet vetem nga specialistet e permendur ne Nenin 24 te kesaj rregulloreje. Aktiviteti pasqyrohet ne librin e dyqanit i cili plotesohet sipas Shtojces 9 te kesaj Rregulloreje.

### **Neni 35**

Magazinat dhe dyqanet e PMB-ve duhet te jene te pajisura me mjetet e nevojeshme per shuarjen e zjarreve, asgjesimin e ambalazheve te demtuara dhe PMB-ve te rrjedhura, kendin higjeniko-shendetesor, te ndihmes se shpejte dhe pajisjet mbrojtese vetiake.

Punonjesit e magazinave te PMB-ve duhet te jene te pajisur me Deshmi Aftesie.

### **Neni 36**

Miratimi i vendeve (shesheve) te ngritjes se magazinave a dyqaneve te PMB-ve dhe i projekteve te ndertimit te tyre, behet sipas ligjeve ne fuqi pas dhenies se pelqimit nga nje komision ne shkalle rrethi i perbere nga inspektori i mbrojtjes se bimeve, inspektori sanitar shteteror, inspektori i mbrojtjes se mjedisit dhe perfaqesuesi i deges se rendit publik.

Komisioni i mesiperm pas ndertimit a pershtatjes se magazinave ose dyqaneve ben miratimin e tyre per tu perdorur per ruajtjen dhe shitjen e PMB-ve.

Ato duhet te jene ndertuar apo pershtatur ne menyre te tille qe te garantojne ruajtjen e cilesive fiziko-kimike te PMB-ve. Te jene te paisura me sisteme ajrosese, te sigurojne nje temperature mjedisi jo me te ulet se 5 grade C dhe jo me te larte se 30 grade C.

### **Neni 37**

Kur gjate ruajtjes se PMB-ve ne magazina a dyqane ndodhin demtime te ambalazheve dhe rrjedhje te PMB-ve, ato largohen nga lokali dhe asgjesohen. Nese PMB-te brenda tyre jane ne gjendje te mire ato futen ne ambalazhe me etiketa origjinale.

**KREU IV**  
**Kualifikimi**  
**per tregetimin dhe perdorimin e PMB-ve**

**Neni 38**

Deshmia e Kualifikimit e permendur ne Nenin 24 te kesaj Rregulloreje jepet nga nje Komision i ngritur per kete qellim prane IMB per ata persona

- te cilet kane mbaruar Fakultetin e Agronomise ,
- kane ndjekur Kursin e Kualifikimit per PMB-te prane IMB dhe
- Komisioni i vlereson se kane pervehtesuar programin e Kursit te Kualifikimit.

Paisja me Deshmi Kualifikimi behet kundrejt pageses vlere e te ciles percaktohet dhe arketohet ne IMB.

**Neni 39**

Deshmite e Aftesise te permendura ne Nenet 35, 40 dhe 41 te kesaj Rregulloreje, jepen nga nje Komision i ngritur per kete qellim prane DBU-se rrethit.

Paisja me Deshmi Aftesie behet kundrejt pageses vlerat e te cilave percaktohen dhe arketohen ne DBU-n e rrethit.

Pergatitja dhe instruktimi i personave qe kerkojne te pajisen me Deshmi Aftesie behet mbi bazen e nje tematike te hartuar nga DBU-ja e rrethit .

Komisioni vlereson njohurite e personit qe kerkon Deshmine e Aftesise per problemet e meposhtme:

- njohuri per perdorimin e PMB-ve.
- njohuri per helmueshmerine e PMB-ve dhe rregullat e perdorimit te sigurte te tyre,
- njohuri per legjislacionin e PMB-ve.

Deshmia e aftesise eshte e vlefshme per 5 vjet nga data e leshimit dhe shoqerohet me deshmine shendetesore te leshur nga komisioni mjeko-ligjor. Ato regjistrohen ne nje liber te veçante sipas Aneksit 2, Shtojca 7 te kesaj Rregulloreje. Deshmia e Aftesise hartohet sipas modelit te paraqitur ne Aneksit 2, Shtojca 8 te kesaj Rregulloreje.

**Neni 40**

Te drejten per te perdorur (perdoruesi i fundit) PMB e kane te gjithë personat qe kane mbushur moshen 18 vjeç, me perjashtim te grave shtatzena deri ne fund te periudhes se laktacionit.

Te drejten per te perdorur (perdoruesi i fundit) PMB te klasave 1a dhe 1b sipas klasifikimit te bere ne Nenin 3 te kesaj Rregulloreje, e kane te gjithë personat e permendur ne Nenin 24 te kesaj rregulloreje si dhe ata qe jane te paisur me Deshmi Aftesie.

**Neni 41**

Te drejten e perdorimit te PMB-ve fumigante me rrezik te madh helmimi si metil bromid, fosfid alumini, fosfid zinku, fosfid magnezi etj. e kane vetem personat e pajisur me Deshmi Aftesie te veçante.

## Detyrime te tregetuesve te PMB-ve

### Neni 71

Tregetuesit e PMB-ve jane te detyruar

1.te vene ne dispozicion te inspektoreve informacionet qe u kerkohen dhe tu krijojne atyre te gjitha kushtet qe u nevoiten per zbatimin e kesaj Rregulloreje.

2.te paraqesin ne fund te vitit ne DBU-ne e rrethit evidencen vjetore me llojet dhe sasite e pesticideve te importuara dhe te shitura.

## Shpenzimet dhe Pagesat per Regjistrimin e PMB-ve

### Neni 72

1.Shpenzimet per Regjistrimin e PMB-ve ndahen ne:

1.1. Shpenzime Administrative

1.2. Shpenzime per vleresimin biologjik - agronomik dhe analizave cilesore gjate procedurave te regjistrimit dhe pas hedhjes ne treg

2.Vlefte e shpenzimeve administrative eshte:

- a. Për PMB-të , Lënda Aktive e të cilave është e përfshirë ne Aneksin 1 të Direktivës 91/414 EEC, 150.000 lekë;
- b. Për PMB-të me Lëndë Aktive të re, 150.000 lekë;
- c. Për PMB-të me Lëndë Aktive të vjetër, 100.000 lekë;
- d. Për PMB-të identike me ato të regjistruarat, 50.000 lekë;
- e. Për rinovimin e regjistrimit, 100.000 lekë;
- f. Për autorizim të përkohëshëm të PMB-së, 50.000 lekë;
- g. Për ndryshime në etiketën e PMB-ve, 30.000 lekë;
- h. Për ndryshim të mbajtësit të dokumentit të regjistrimit të PMB-së, 30.000 lekë.

3.Vlefte e shpenzimeve te permendura ne piken 1.2 te ketij Neni eshte ne vartesi te kosos.

4.Pagesat e Shpenzimeve per Regjistrimin e PMB-ve behen ne IMB.

20% e vlerës së shpenzimeve të mësipërme paguhet nga Aplikanti menjëherë me depozitimin e kërkesës për shërbimet administrative të përmendura në këtë pikë, ndërsa pjesa tjetër pas kryerjes së shërbimit.”

Formularet qe plotesohen per ushtrim aktiviteti ne mbrojtjen e bimeve

**Shtojca Nr. 1**

**KERKESE PER IMPORTIM TE PMB-ve**

1. Emri, Mbiemri/Firma \_\_\_\_\_
2. Profesion/veprimtaria \_\_\_\_\_
3. Punesuar specialiste \_\_\_\_\_  
(Emri,Mbiemri, Specialiteti)
4. Adresa & telefoni \_\_\_\_\_
5. PMB-ja qe do te importohet:
  - a)emri tregtar \_\_\_\_\_
  - b)emri teknik i lendes aktive \_\_\_\_\_
  - c)permbajtja e lendes aktive \_\_\_\_\_
  - ç)lloji i ambalazhimit \_\_\_\_\_
  - d)Numri dhe data e dokumentit te regjistrimit ne Shqiperi \_\_\_\_\_
6. Emri i prodhuesi, Adresa/tel. \_\_\_\_\_
7. Emri i shitesit, Adresa/tel. \_\_\_\_\_
8. Vendi i magazinimit (Emri, Mbiemri i magazinuesit, Adresa, Telefoni) \_\_\_\_\_
9. Pikat doganore te hyrjes \_\_\_\_\_

- |  |   |
|--|---|
| <ol style="list-style-type: none"><li>1. A jeni i denuar ndonjehere per veprimtari te jashteligjshme me PMB?</li><li>2. A keni dijeni te plota per ligjet dhe rregullat ne fuqi per transportimin, ruajtjen, tregtimin, shitjen, perdorimin, mbrojtjen e shendetit te njerezve, te kafsheve e ruajtjen e mjedisit dhe asgjesimin e PMB-ve e ambalazheve te tyre?</li></ol> | <p><b>PO+</b></p> <p><b>+</b></p> <p><b>JO</b> <input type="checkbox"/></p> <p><b>PO</b> <input type="checkbox"/>      <b>JO</b> <input type="checkbox"/></p> |
|--|---|

Firma:-----

**Shtojca Nr . 2**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E BUJQESISE DHE USHQIMIT**  
**(Drejtoria e Sherbimit te Mbrojtjes se Bimeve)**

**LEJE IMPORTIMI PER PMB**

Ne mbeshtetje te Ligjit "Per Sherbimin e Mbrojtjes se Bimeve" Nr.7662 date 19.1.1993 dhe Ligjit Nr. 8529, date 23.9.199 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr.7662, date 9.1.1993 Per Sherbimine Mbrojtjes se Bimeve" ,

Subjekti Tregetar \_\_\_\_\_

*Emri I Subjektit*

*Adresa*

*Nr.Tel.*

**Lejohet te importoi Produktet e Mbrojtjes se Bimeve te regjistruara per tu perdorur ne teritorin e Republikes se Shqiperise.**

MINISTRI

( \_\_\_\_\_ )

**Shtojca Nr. 3**

**KERKESE PER TREGETIMIN e PMB-ve**

1. Emri, Mbiemri/ Firma \_\_\_\_\_
  2. Profesioni/Veprimtaria \_\_\_\_\_
  3. Punesuar specialiste \_\_\_\_\_
- (Emri, Mbiemri i specialistit)**
4. Adresa, Telefoni \_\_\_\_\_

<p>1. A jane dyqanet/magazinat tuaja te miratuara per shitje sipas ligjeve e akteve nenligjore ne fuqi ?</p>	PO <input type="checkbox"/>	JO <input type="checkbox"/>
<p>2. A jeni denuar ndonjehere per veprimtari te jashteligjshme me PMB?</p>	PO <input type="checkbox"/>	JO <input type="checkbox"/>
<p>3. A keni dijeni te plota per rregullat ne fuqi per transportimin, magazinimin, tregetin, mbrojtjen e shendetit te njerezve dhe kafsheve, ruajtjen e mjedisit dhe asgjesimin e PMB-ve e ambalazheve te tyre?</p>	PO <input type="checkbox"/>	JO <input type="checkbox"/>

**Shenim: Pergjigja shenohet me X.**

Firma:-----

-

5. Vendndodhja e magazinave \_\_\_\_\_

(Adresa, Telefoni, Pershkrimetopografik i vendndodhjes se magazinave)

Firma

**Shtojca Nr . 4**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E BUJQESISE DHE USHQIMIT**  
**Drejtoria e Bujqesise dhe Ushqimit**  
**Rrethit \_\_\_\_\_**

**LEJE PER TREGETIMIN E PMB-ve**  
**Nr. \_\_\_\_\_ Date. \_\_\_\_\_**

Ne mbeshtetje te Ligjit "Per Sherbimin e Mbrojtjes se Bimeve" Nr.7662 date 19.1.1993 dhe Ligjit Nr. 8529, date 23.9.199 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr.7662, date 9.1.1993 Per Sherbimine Mbrojtjes se Bimeve" ,

Subjekti Tregetar \_\_\_\_\_  
*Emri I Subjektit* *Adresa* *Nr.Tel.*

**,Z/Firmes** \_\_\_\_\_

(Emri, Mbiemri/ Emri i Firmes/ Adresa, Tel)

I jepet e drejta te tregetoje PMB. Ato do te ruhen dhe tregetohen ne:

\_\_\_\_\_  
(Adresa, Telefoni).

**DREJTORI**


( \_\_\_\_\_ )

**Shtojca Nr. 8**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E BUJQESISE DHE USHQIMIT**

**(Drejtoria e Bujqesise dhe Ushqimit)**

**Rrethi \_\_\_\_\_**



**DESHMI AFTESIE  
PER TE PUNUAR ME PMB**

**Nr. \_\_\_\_\_**

I leshohet zotit \_\_\_\_\_ i cili eshte i instruktuar posaçerisht dhe

*Emri, emri i babes, mbiemri*

ka fituar njohurite e mjaftueshme per te punuar me PMB-te e \_\_\_\_\_

(Iloji i PMB-ve per te cilat leshohet kjo Deshmi)

Leshuar me \_\_\_\_\_

E vlefshme per 5 vjet nga data e leshimit dhe vetem kur shoqerohet me deshmine shendetesore te leshuar nga komisioni mjeko-ligjor.

**MBAJTESI I DESHMISE**

*(Emri, Mbiemri, Firma)*

**PER KOMISIONIN**

**KRYETARI**

**TE DHENAT QE DUHET TE PERMBAJE DOSJA E REGJISTRIMIT**

**I . LENDET AKTIVE ME NATYRE KIMIKE**

**A . Per PMB-te te cilat permbajne lende aktive  
qe nuk perfshihen ne ndonje nga PMB-te e regjistruara.**

**1. Identiteti i PMB-se**

- 1.1. Aplikuesi dhe Mbjatesi i Dokumentit te Regjistrimit (Emri, Adresa, etj.).
- 1.2. Prodhuesi i PMB-se, emri, adresa, etj, perfshire vendndodhjen e impianteve te prodhimit.
- 1.3. Emri tregetar ose emri tregetar i propozuar dhe kodi i prodhuesit per PMB-ne (nese ka).
- 1.4. Informacion i detajuar per perberjen sasiore dhe cilesore te produktit (lenda/lendet aktive, papastertite, shtuesit, perberesit inerte, etj.)
- 1.5. gjendja fizike dhe natyra e PMB-se (koncentrat i emulsionueshem, pluhur i lagshem, solucion per trajtimin e farave, etj.)
- 1.6. Kategoria e PMB-se (herbicid, insekticid, etj.)

**2. Vetite fizike, kimike dhe teknike te PMB-se.**

- 2.1. Aparenca (ngjyra dhe era).
- 2.2. Vetite eksplozive dhe oksiduese.

- 2.3. Pika e ndezjes dhe tregues te tjere te djegshmerise ose te ndezjes spontane.
- 2.4. Aciditeti/alkaliniteti dhe nese eshte e nevojshme vlera e pH (ne perqendrimin 1% ne uje)
- 2.5. Viskoiziteti, tensioni siperfaqesor.
- 2.6. Densiteti relativ.
- 2.7. Qendrueshmeria ne ruajtje. Efektet e drites, temperatures dhe lageshtise ne karakteristikat e PMB-

se.

## 2.8. Karakteristikat teknike te PMB-se

### 2.8.1. Lagshmeria.

### 2.8.2. Qendrueshmeria e shkumes.

### 2.8.3. Suspensibiliteti dhe qendrueshmeria e suspensionit.

### 2.8.4. Testi i sitjes se lagur dhe sitjes se thate.

### 2.8.5. Shperndarja e madhese se grimcave

2.8.6. Ne rastin e granulave; testi i sitjes dhe treguesi i shperndarjes se peshes se granulave, te pakten per fraksionin me madhesi grimcash me te madhe se 1 mm.

### 2.8.7. Permbajtja e lendes aktive ne ose mbi grimcat e ushqimit te helmuar, granula ose faren e trajtuar.

### 2.8.8. Emulsionimi, dhe qendrueshmeria e emulsionit.

### 2.8.9. Perzierja me me produkte te tjera,

## 3. Te dhena per perdorimin

### 1.1. Fusha e perdorimit,

1.2. Menyra e veprimit, p.sh. veprim kontakti, frymemarrje ose te brendshem (stomaku), fungitoksik ose fungistatik, etj., sistemik ose jo sistemik ne bime.

3.3. Hollesira per perdorimin e parashikuar p.sh. organizmat demtues qe lufton dhe/ose bimet ose produktet bimore qe mbron.

3.4. Ku eshte e nevojshme, simbas rezultatit te provave, kushtet specifike agroteknike, te shendetit te bimeve dhe/ose kushtet mjedisore ne te cilat mund te perdoret ose te mos perdoret.

### 3.5. Doza e rekomanduar e perdorimit.

### 3.6. Menyra e perdorimit.

### 3.7. Numri i trajtimeve, koha e perdorimit dhe kohezgjatje e efektit mbrojtjes.

3.8. Periudha e nevojshme e pritjes ose masa te tjera paraprake per te evituar efektet fitotoksike ne bimet pasardhese.

### 3.9. Etiketa e propozuar.

## 4. Informacion plotesues per PMB-ne.

### 4.1. Ambalazhimi (tipi, materialet, madhesia, etj.)

4.2. Periudha e rihyrjes ne ambientin e trajtuar, periudha e nevojshme e pritjes (karenca) ose masa te tjera paraprake per mbrojtjen e njerezve dhe kafsheve.

4.3. Metodrat e rekomanduara dhe kushtet paraprake ne lidhje me mbajtjen, magazinimin, transportin dhe mbrojtjen nga zjarri.

### 4.4. Masat emergjente ne rast helmimi. Keshilla per mjekun. Terapia. Antidotet.

### 4.5. Identiteti i produkteve te djegies ne rast zjarri.

### 4.6. Procedura e asgjesimit te PMB-se dhe ambalazhit te tij.

#### 4.6.1. Mundesia e neutralizimit.

#### 4.6.2. Kontrolli i rrjedhjeve.

#### 4.6.3. Diegja e kontrolluar.

#### 4.6.4. Pastrimi i ujit.

## 5. Metodrat analitike

5.1. Metodrat analitike per percaktimin e permbajtjes se lendes aktive.

## 6. Te dhena per efikasitetin

6.1. Testet paraprake per percaktimin e dozave.

- 6.2. Eksperimentet fushore.
- 6.3. Informacion mbi mundesine e çfaqjes dhe zhvillimit te rezistences.
- 6.4. Efekti ne cilesine dhe ku eshte e nevojshme ne rendimentin e bimeve te trajtuara.
- 6.5. Fitotoksiciteti per bimet qe do trajtohen (perfshire kultivaret e ndryshem)
- 6.6. Vrojtime per efektet anesore te padeshiruara dhe te papritura p.sh. per organizmat e dobishem dhe ata qe nuk jane objekt i luftimit, per bimet pasardhese, etj.

## **7. Studimet per toksicitetin e PMB-se**

- 7.1. Toksiciteti akut
  - 7.1. oral
  - 7.2. nga lekura
  - 7.3. me frymemarrje
  - 7.4. iritimi i lekures dhe syve
  - 7.5. ndjeshmeria e lekures
  - 7.6. Ekspozimi i punetoreve
  - 7.7. Absorbimi nga lekura

## **8. Identiteti i lendes aktive**

- 8.1. Prodhuesi (emri, adresa, perfshire vendndodhjen e impianteve)
- 8.2. Emri kimik (sipas nomenklatures se IUPAC)
- 8.3. Emri i zakoneshem (ISO)
- 8.4. CAS No.
- 8.5. CIPAC No.
- 8.6. Formula e struktures
- 8.7. Formula empirike
- 8.8. Pesha molekulare
- 8.9. Metoda e prodhimit (rruga e sintezes) te lendes aktive
- 8.10. Minimumi i lendes vepruese qe permbahet ne materialin teknike.
- 8.11. Identiteti i izomereve, papastertive dhe shtuesve (psh stabilizuesve) se bashku me formulat strukturore dhe permbajtjes se mundshme te shprehur ne g/kg ose g/l
- 8.12. Permbajtja e fraksioneve te pa identifikueshem.

## **9. Vetite fizike dhe kimike te lendes aktive**

- 9.1. Pika e shkrirjes, pika e vlimit, densiteti relativ
- 9.2. Presioni i avujve (ne Pa) ne 20°C, avullueshmeria (psh konstantja e ligjit te Henrit)
- 9.3. Aparenca (gjendja fizike, ngjyra, era, shija)
- 9.4. Spektri i absorbimit (UV/VIS, IR, NMR, MS), shperberja molekulare ne gjatesite perkatese te valeve.
- 9.5. Tretshmeria ne uje perfshire efektin e pH (5-9) dhe temperatures
- 9.6. Tretshmeria ne tretes organike perfshire efektin e pH.
- 9.7. Koeficienti pjesor N-octanol/uje perfshire efektin e pH (5-9) dhe temperatures
- 9.8. Qendrueshmeria termike
- 9.9. Djegshmeria perfshire vetendezjen dhe identitetin e produkteve te djegies
- 9.10. Pika e ndezjes
- 9.11. Vetite eksplozive
- 9.12. Veprimi ndaj materialit te ambalazhimit

## **10. Metodot analitike**

- 10.1. Metodot analitike per percaktimin e lendes aktive te paster dhe per produktet e zberthimit, izomeret dhe papastertite e lendes aktive dhe shtuesve (psh stabilizuesve)

## **11. Studimet toksikologjike te lendes aktive**

- 11.1. Toksiciteti akut
- 11.2. oral
- 11.3. nga lekura
- 11.4. me frymemarrje
- 11.5. me injektim nen lekure
- 11.6. irritimi i lekures dhe syve
- 11.7. ndjeshmeria e lekures
- 11.8. Toksiciteti afat-shkurter
- 11.9. Toksiciteti akumulues nga goja (studim 28-ditesh)
- 11.10. Toksiciteti sub-kronik - dy specie, njera brejttese (me preference mi) dhe njera jo brejttese, zakonisht studim 90-ditesh.
- 11.11. Rruget e tjera (nepermjet frymemarrjes, lekures).
- 11.12. Toksiciteti kronik
- 11.13. Toksiciteti kronik nga goja dhe kancerogjeniciteti (minj dhe specie te tjera gjitare).
- 11.14. Mutagjeniciteti - grup provash per vleresimin e ndryshimit te geneve, shmangiet e kromozoneve dhe tronditjet e ADN.
- 11.15. Toksiciteti riprodhues
- 11.16. Studimet per teratogjenicitetin - lepur dhe nje specie tjeter brejttese, nga goja dhe kur eshte e mundshme nga lekura.
- 11.17. Studime shume-breznish ne gjitare (te pakten 2 brezni).
- 11.18. Studime per metabolizmin ne gjitaret
- 11.19. Studime per absorbimin, shperndarjen dhe nxjerrjen jashte trupit (per marrjen nga goja dhe nga lekura).
- 11.20. Sqarimi i rrugeve te metabolizmit.
- 11.21. Studime per neurotoksicitetin duke perfshire provat per neurotoksicitetin e vonuar ne pulat e rritura.
- 11.22. Efektet toksike te metaboliteve nga bimet e trajtuara ne rastet kur jane te ndryshme nga ato te identifikuar ne studimet ne kafshe.
- 11.23. Studime te tjera qe nevoiten per te sqaruar efektet e verejtura ne studimet per toksicitetin.
- 11.24. Efektet toksike ne blegtori dhe kafshet shtepiake.

## **12. Mbetjet ne ose mbi produktet e trajtuara, ushqimet dhe ushqimet per blegtorine ku propozohet te perdoret.**

- 12.1. Efektet e mbetjeve per prishjen, eren, shijen dhe aspekte te tjera cilesore te produkteve te fresketa ose te perpunuara.
- 12.2. Te dhena per mbetjet ne kulturat pasardhese kur mund te pritet prezenca e tyre.
- 12.3. Periudha e propozuar e pritjes (karenca) per perdorimet e parashikuara, ose periudha e ruajtjes ose magazinimit per perdorimin pas vjeljes.
- 12.4. Nivelet maksimale te mbetjeve (MRLs) ne produktet bimore.
- 12.5. Metodatat analitike te mbetjeve duke perfshire limitet e percaktimit ne dhe ku eshte e nevojshme mbi:
  - 12.5.1. bimet e trajtuara, produktet bimore, ushqimet, ushqimet per blegtorine
  - 12.5.2. toke
  - 12.5.3. uje (perfshire ujin e pijshem)
  - 12.5.4. ajer.

## **13. Fati dhe sjellja ne mjedis**

- 13.1. Prova per perhapjen dhe shperndarjen ne toke
- 13.2. Prova per perhapjen dhe shperndarjen ne uje
- 13.3. Prova per perhapjen dhe shperndarjen ne ajer

## **14. Studimet ekotoksikologjike**

- 14.1. Efektet tek zogjte
- 14.2. Toksiteti akut nga goja
- 14.3. Efektet tek organizmat ujore
- 14.4. Toksiteti akut per peshqit
- 14.5. Toksiteti akut per Daphnia magna
- 14.6. Toksiteti akut per algat
- 14.7. Rreziku ne rastet e perdorimit rreth siperfaqeve ujore
- 14.8. Efektet ne organizmat e tjera qe nuk jane objekt i luftimit
- 14.9. Efektet tek bleta
- 14.10. Efektet tek krimbat e tokes
- 14.11. Efektet tek mikroorganizmat e tokes qe nuk jane objekt i luftimit

## **15. Informacion plotesues**

- 15.1. Informacion per Regjistrimet ne vende te tjera
- 15.2. Informacion mbi inkludimin e lendes aktive ne ne Aneksin I te Direktivs No.91/414/EEC
- 15.3. Informacion per nivelet maksimale te mbetjeve te vendosura ne shtetet e tjera
- 15.4. Propozime perfaqshme dhe justifikimet per klasifikimin e PMB-se ne baze te toksitetit te tij si dhe simbolet e rrezikut, treguesit e rrezikut, frazat e rrezikut dhe sigurise qe duhet te vihen ne etikete
- 15.5. Mostra te PMB ne ambalazhin e propozuar dhe ne sasine qe kerkohen per ngritjen e eksperimentimeve te efikasitetit dhe fitotoksitetit.

## **16. Fleta me te dhenat per sigurine (safety data sheet) te PMB-se.**

## **17. Mostra e Lendes Aktive ( 2 x 1 gram)**

### **B . Per PMB-te te cilat permbajne te njejtat lende aktive me ato te PMB-ve tashme te regjistruara ne Shqiperi por me lende aktive te prodhuar nga prodhues te tjere (P.M.B-te Xhenerike)**

#### **1. Identiteti i PMB-se**

- 1.1. Aplikuesi dhe Mbajtesi i Dokumentit te Regjistrimit (Emri, Adresa, etj.).
- 1.2. Prodhuesi i PMB-se, emri, adresa, etj, perfaqshme vendndodhjen e impianteve te prodhimit.
- 1.3. Emri tregetar ose emri tregetar i propozuar dhe kodi I prodhuesit per PMB-ne (nese ka).
- 1.4. Informacion i detajuar per perberjen sasiore dhe cilesore te produktit (lenda/lendet aktive, papastertite, shtuesit, perberesit inerte, etj.)
- 1.5. gjendja fizike dhe natyra e PMB-se (koncentrat i emulsionueshem, pluhur i lagshem, solucion per trajtimin e farave, etj.)
- 1.6. Kategoria e PMB-se (herbicid, insekticid, etj.)

#### **2. Vetite fizike, kimike dhe teknike te PMB-se.**

- 2.1. Aparenca (ngjyra dhe era).
- 2.2. Vetite eksplozive dhe oksiduese.
- 2.3. Pika e ndezjes dhe tregues te tjere te djegshmerise ose te ndezjes spontane.
- 2.4. Aciditeti/alkaliniteti dhe nese eshte e nevojshme vlera e pH (ne perqendrimin 1% ne uje)
- 2.5. Viskoziteti, tensioni siperfaqesor.
- 2.6. Densiteti relativ.

2.7. Qendrushmeria ne ruajtje. Efektet e drites, temperatures dhe lageshtise ne karakteristikat e PMB-set.

2.8. Karakteristikat teknike te PMB-se

2.8.1. Lagshmeria.

2.8.2. Qendrushmeria e shkumes.

2.8.3. Suspensibiliteti dhe qendrushmeria e suspensionit.

2.8.4. Testi i sitjes se lagur dhe sitjes se thate.

2.8.5. Shperndarja e madhesise se grimcave

2.8.6. Ne rastin e granulave; testi i sitjes dhe treguesi i shperndarjes se peshes se granulave, te pakten per fraksionin me madhesi grimcash me te madhe se 1 mm.

2.8.7. Permbajtja e lendes aktive ne ose mbi grimcat e ushqimit te helmuar, granula ose faren e trajtuar.

2.8.8. Emulsionimi, dhe qendrushmeria e emulsionit.

2.8.9. Perzierja me produkte te tjera,

### **3. Te dhena per perdorimin**

3.1. Etiketa e propozuar.

### **4. Informacion plotesues per PMB-ne.**

4.1. Ambalazhimi (tipi, materialet, madhesia, etj.)

4.2. Masat emergjente ne rast helmimi. Keshilla per mjekun. Terapia. Antidotet.

### **5. Metodot analitike**

5.1. Metodot analitike per percaktimin e permbajtjes se lendes aktive.

### **6. Studimet per toksicitetin e PMB-se**

6.1. Toksiciteti akut

6.2. oral

6.3. nga lekura

6.4. me frymemarrje

6.5. iritimi i lekures dhe syve

6.6. ndjeshmeria e lekures

6.7. Toksiciteti ndaj organizmave ujore.

6.8. Toksiciteti ndaj bleteve

### **7. Identiteti i lendes aktive**

7.1. Prodhuesi (emri, adresa, perfshire vendndodhjen e impianteve)

7.2. Emri kimik (sipas nomenklatures se IUPAC)

7.3. Emri i zakoneshem (ISO)

7.4. CAS No.

7.5. CIPAC No.

7.6. Formula e struktures

7.7. Formula empirike

7.8. Peshat molekulare

7.9. Metoda e prodhimit (rruga e sintezes) se lendes aktive.

7.10. Minimumi i lendes aktive qe permbahet ne materialin teknike.

7.11. Identiteti i izomereve, papastertive dhe shtuesve (psh stabilizuesve) se bashku me formulat strukture dhe permbajtjes se mundshme te shprehur ne g/kg ose g/l

7.12 Permbajtja e fraksioneve te pa identifikueshem.

### **8. Vetite fizike dhe kimike te lendes aktive**

8.1. Presioni i avujve (ne Pa) ne 20°C, avullueshmeria (psh konstantja e ligjit te Henrit)

- 8.2. Tretshmeria ne uje
- 8.3. Koeficienti I vecimit N-octanol/uje perfshire efektin e pH (5-9) dhe temperatures
- 8.4. Temperatura e shkrirjes

## **9. Metodatat analitike**

9.1. Metodatat analitike per percaktimin e lendes aktive te paster dhe per produktet e zberthimit, izomeret dhe papastertite e lendes aktive dhe shtuesve (psh stabilizuesve)

## **10. Studimet toksikologjike te lendes aktive**

- 10.1. Toksiteti akut
- 10.2. oral
- 10.3. nga lekura
- 10.4. me frymemarrje
- 10.5. me injektim nen lekure
- 10.6. irritimi i lekures dhe syve
- 10.7. ndjeshmeria e lekures

## **11. Mbetjet ne ose mbi produktet e trajtuara, ushqimet dhe ushqimet per blegtorine ku propozohet te perdoret.**

11.1. Efektet e mbetjeve per prishjen, eren, shijen dhe aspekte te tjera cilesore te produkteve te fresketa ose te perpunuara.

11.2. Periudha e propozuar e pritjes (karenca) per perdorimet e parashikuara, ose periudha e ruajtjes ose magazinimit per perdorimin pas vjeljes.

11.3. Nivelet maksimale te mbetjeve (MRLs) ne produktet bimore.

## **12. Informacion plotesues**

12.1. Informacion per Regjistrimet ne vende te tjera

12.2. Informacion mbi inkludimin e lendes aktive ne ne Aneksin I te Direktivs No.91/414/EEC

12.3. Informacion per nivelet maksimale te mbetjeve (MRLs) te vendosura ne vende te tjera

12.4. Propozime perfshire dhe justifikimet per klasifikimin e PMB-se ne baze te toksitetit te tij si dhe simbolet e rrezikut, treguesit e rrezikut, frazat e rrezikut dhe sigurise qe duhet te vihen ne etikete

12.5. Mostra te PMB ne ambalazhin e propozuar dhe ne sasine qe kerkohen per ngritjen e eksperimentimeve te efikasitetit dhe fitotoksitetit.

## **13. Fleta me te dhenat per sigurine (safety data sheet) te PMB-se.**

## **14. Mostra e Lendes Aktive ( 2 x 1 gram)**